



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument Parlamentar

Tiranë, më 09.07.2018

**RAPORT
PËR
PROJEKTLIGJIN
“PËR
RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS, NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE
ZHVILLIM, PËR SHITESËN E FINANCIMIT PËR PROJEKTIN E
MODERNIZIMIT TË ASISTENCËS SOCIALE”**

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 09.07.2018, mori në shqyrtim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për shtesën e financimit për projektin e modernizimit të asistencës sociale”.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputetin Edmond Leka.

Në mbledhjet e Komisionit për të mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të Komisionit ishin të pranishëm znj. Bardhylka Kospiri, zëvendësministre e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe përfaqësues të kësaj ministrie si dhe zëvendësministri i Financave dhe Ekonomisë z. Erjon Luçi dhe përfaqësues të kësaj ministrie

Komisioni e shqyrton këtë projektligj në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 83 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Ratifikimi i kësaj marrëveshje bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kreu II “Marrëveshjet Ndërkombëtare”, neni 121 i saj.

II. QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Projektligji ka si qëllim, ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për shtesën e financimit për projektin e modernizimit të asistencës sociale, nëpërmjet akordimit të një huaje në shumën 11 milionë USD.

Marrëveshja bazë e huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për financimin e projektit të modernizimit të asistencës sociale është nënshkruar më 6 qershor 2012 dhe është ratifikuar nga Kuvendi me ligjin nr.84/2012, datë 18.9.2012. Objekt i kësaj marrëveshje fillestare huaje është mbështetja e zbatimit të reformave nga ana e Huamarrësit për përmirësimin e barazisë dhe efikasitetit të programeve të tij të ndihmës sociale.

Shtesa e financimit për projektin e modernizimit të asistencës sociale, ka për qëllim të mbështesë zbatimin e reformave të ndërmarra për përmirësimin e vendosjes së drejtësisë dhe rritjen e efikasitetit të programeve të ndihmës sociale në Shqipëri.

Zbatimi i projekti është i ndarë në dy pjesë:

- *Pjesa 1: Forcimi i zbatimit dhe performancës së programeve të asistencës sociale*
Mbështetja e zbatimit të përmirësuar, si e programit të ndihmës ekonomike, ashtu edhe e programit të aftësisë së kufizuar (PAK), nëpërmjet dhënies së financimit për rimbursimin e pagesave që Huamarrësi ka kryer nga fondet e tij buxhetore për programin e ndihmës ekonomike

- *Pjesa 2: Asistenca teknike për forcimin e kapacitetit zbatues për programet e asistencës sociale ku përfshihen:*

- a) Rishikimi i parametrave të programeve të ndihmës sociale, duke përfshirë sistemet e reja të vlerësimit për asistencën për personat me aftësi të kufizuar në bazë të modelit social dhe shqyrtimin e procedurave të punës dhe kuadrit institucional dhe hartimin e strategjive të asistencës alternative për personat me aftësi të kufizuar.

- b) Përgatitje e një strategjie novatore dhe të mbështetur në përvojën ndërkombëtare për daljen e përfituesve të ndihmës ekonomike dhe integrimin e tyre drejt skemave aktive;

- c) përgatitjen e një politike të rishikuar për sanksionet dhe hartimin e instrumenteve për zbulimin e mashtrimeve e të gabimeve dhe mekanizmave të tjerë të inspektimit social;

- d) Nxitja e transparencës në komunikim dhe në procesin e monitorim-vlerësim, si edhe në angazhimin e qytetarëve në këto procese.

Afati i fundit për tërheqjen e fondeve të akorduara nëpërmjet kësaj marrëveshjeje huaje është data 30 qershor 2021.

Marrëveshja e huas është miratuar, në parim, nga Këshilli i Ministrave, me vendimin nr.206, datë 11.4.2018, dhe është nënshkruar ndërmjet palëve. Në përputhje me ligjin nr.43/2016, datë 21.4.2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, marrëveshja do t’i nënshtrohet procedurës së ratifikimit.

III.PËRFUNDIM

Në përfundim të shqyrtimit të këtij projektligji, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se:

Në aspektin ligjor, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, e miratoi atë me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm dhe u shpreh dakord për kalimin për votim në seancë plenare.

R E L A T O R I

EDMOND LEKA

KRYETARI

ULSI MANJA